



REPUBLIKA E SHQIPERISE
ENTI RREGULLATOR I ENERGJISE

VENDIM

Nr. 144 Datë 24.10.2012

PËR
FILLIMIN E PROCEDURAVE PËR RISHIKIMIN E RREGULLAVE TË
TREGUT SHQIPTAR TE ENERGJISE ELEKTRIKE MIRATUAR ME
VENDIMIN E BORDIT TË KOMISIONERËVE NR. 68, DATË 23.06.2008

Në mbështetje të nenit 8, pika 2, gërma ç, paragrafi “ii”, 9 dhe 54 të Ligjit nr. 9072, datë 22.05.2003, “Për Sektorin e Energjisë Elektrike”, të ndryshuar, nenit 26 të Rregullave të Praktikës dhe Procedurave të ERE-s, miratuar me Vendimin të Bordit të Komisionerëve të ERE-s, nr. 21, datë 18.03.2009, të ndryshuar, Bordi i Komisionerëve të Entit Rregullator të Energjisë (E.R.E), në mbledhjen e tij të datës 24.10.2012, mbasi shqyrtoi relacionin e Drejtorisë Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit dhe Drejtorisë së Liçensimit dhe Monitorimit të Tregut, në lidhje me nisjen e procesit të rishikimit të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike,

Vendosi:

1. Fillimin e procedurave për rishikimin e Kapitullit X, të Rregullave të Tregut Shqiptar të Energjisë Elektrike, miratuar me Vendimin e Bordit të Komisionerëve nr. 68, datë 23.06.2008.
2. Drejtoria Juridike dhe Mbrojtjes së Konsumatorit të njoftojë shoqëritë KESH sh.a, OST sh.a dhe CEZ Shpërndarje sh.a, për vendimin e Bordit të Komisionerëve.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Ky vendim botohet në Fletoren Zyrtare.

KRYETARI
Sokol RAMADANI